LIGJ
Nr.10 052, datë 29.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996 "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.".

Neni 2

Në nenin 35 shkronjat "a" e "b", fjalët "10 milionë lekë" zëvendësohen me fjalët "20 milionë lekë vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi.".

Neni 3

Në nenin 73, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.".

Neni 4

Neni 133 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 133

Kur marrësit nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit.".

Neni 5

Pas nenit 141 shtohet neni 141/a me këtë përmbajtje:

“Neni 141/a

Kur njoftimi për personat juridikë, sipas nenit 141 të këtij Kodi, nuk është i mundur, ky njoftim bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.”.

Neni 6

Pas nenit 144 shtohet neni 144/a me këtë përmbajtje:

“Neni 144/a

Rregullat e parashikuara në këtë kre për njoftimet zbatohen nga përmbaruesit gjyqësorë.”.

Neni 7

Në nenin 152, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër.”.

Neni 8

Në nenin 158/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:
1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
“Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre. Gjyqtari, me vendim, kryen këto veprime:”.
2. Paragrafi i katërt shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 161, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur.”.

Neni 10

Në nenin 202 paragrafi i parë, pas fjalës “gjykata” shtohen fjalët “brenda 5 ditëve”.

Neni 11

Në nenin 232, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
“Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument.”.

Neni 12

Pas nenit 485 shtohet neni 485/a me këtë përmbajtje:

"Neni 485/a
Pasojat kur prishet vendimi i padrejtë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht

Kur vendimi i ri, që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar, tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar detyrohet t'i kthejë të gjitha përfitimet e marra nga ekzekutimi i vendimit.".

Neni 13

Në nenin 494, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:

"ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.".

Neni 14

Në nenin 495 fjalët "nenin 96" zëvendësohen me fjalët "nenin 290".

Neni 15

Në nenin 510, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;".

Neni 16

Në nenin 511 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalia e dytë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

"Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet:".

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përmbarimit, pas njoftimit të vendimit.".

Neni 17

Neni 515 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 515
Vënia në ekzekutim

Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);

b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);

c) pagesën e tarifës së vënies në ekzekutim;

ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore.

Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, përmbaruesi i lë kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive. Kur kërkuesi nuk plotëson këto mangësi brenda afatit të caktuar, dokumentacioni i kthehet atij. Kur mangësitë janë shmangur në afatin e caktuar, kërkesa për vënien në ekzekutim quhet e regjistruar nga data që është paraqitur pranë përmbaruesit gjyqësor.

Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës së kreditorit.

Vendimi i gjykatës për masën e sigurimit të padisë dhe gjobat e gjykatës vihen në ekzekutim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes për ekzekutim.

Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrit ekzekutiv nuk parapaguhet në raste të parashikuara me ligj apo akte të tjera normative.”.

Neni 18

Në fund të nenit 516 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky nen nuk zbatohet për personat, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor, të organizuar mbi baza private.”.

Neni 19

Pas nenit 516 shtohet neni 516/a me këtë përmbajtje:

“Neni 516/a

Në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, në bazë të nenit 515 të këtij ligji, duhet të regjistrojë, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë. Çdo përmbarues gjyqësor është i detyruar të njihet me të dhënat e regjistrit.

Nëse me fillimin e procedurës me objekt “Ekzekutim detyrimesh në të holla” përmbaruesi gjyqësor, nga të dhënat e marra nga regjistri qendror, vëren se kreditorë të tjerë janë në procedurë ekzekutimi ndaj të njëjtit debitor, me të njëjtin objekt, atëherë pezullon procedurën e nisur dhe drejton kreditorin e tij te përmbaruesi gjyqësor, i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim.

Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor, që ka regjistruar i pari kërkesën, vijon procedurën e ekzekutimit, në përputhje edhe me nenin 534 e në vijim të këtij Kodi.

Me pezullimin e procedurës së ekzekutimit, tarifa e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, së bashku me dokumentacionin, i kthehen kreditorit.

Ky nen nuk zbatohet kur në cilësinë e palës debitore është shteti.”.

Neni 20

Në nenin 517 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor.”.

2. Në paragrafin e dytë, pas fjalëve “rrethanave të tjera të çështjes” shtohen fjalët “pasi dëgjon edhe kreditorin”.

Në fjalinë e fundit të këtij paragrafi, pas fjalëve “Vendimi jepet në seancë gjyqësore”

shtohen fjalët “brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

Neni 21

Në nenin 522, pas fjalëve “për këtë rrethanë” shtohen fjalët “brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbaruesit gjyqësor”.

Neni 22

Neni 523 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 523
Detyrimi për bashkëpunim

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përmbaruesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë.

Në rast nevoje, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit.

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, inspektorati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit.

Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor kërkon asistencën e psikologut, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim.”.

Neni 23

Neni 525 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 525

Tarifat e përcaktuara për ekzekutimin e urdhrit ekzekutiv paguhen fillimisht nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera gjatë procedurës së ekzekutimit paguhen nga pala, që i ka shkaktuar ato.”.

Neni 24

Në fund të nenit 528 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të debitorit, sekuestroja mund të vihet, përveç pasurive të rënduara me peng dhe hipotekë, edhe mbi një pasuri tjetër të tij, të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se ajo plotëson kërkesën e kreditorit.”.

Neni 25

Në nenin 529, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.”.

Neni 26

1. Titulli i nenit 532 bëhet “Llogaria në bankë e zyrës së përmbarimit dhe e përmbaruesit gjyqësor”.

2. Në nenet 532 dhe 595, fjalët “llogaria e përmbaruesit gjyqësor” zëvendësohen me fjalët “llogari të zyrës së përmbarimit ose në llogari të përmbaruesit gjyqësor”.

Neni 27

Neni 533 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 533

Sekuestroja e pagës së debitorit

Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

Neni 28

Në fund të nenit 540 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Përmbaruesi gjyqësor bën sekuestrimin e pasurive të luajtshme, mbi të cilat vendoset një etiketë e shërbimit të përmbarimit.”.

Neni 29

Neni 551 shfuqizohet.

Neni 30

Neni 552 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 552

Çmimi i sendit të sekuestruar caktohet nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre, thirret një ekspert.”.

Neni 31

Në nenin 553 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli bëhet “Shitja e lirë e sendit”.

2. Paragrafi i dytë dhe i tretë shfuqizohen.

3. Paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Në qoftë se brenda 2 muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përmbaruesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi.”.

Neni 32

Neni 554 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 554

Përmbaruesi gjyqësor, pasi njofton palët se sendi, për shkak të natyrës ose të gjendjes,

nuk mund të pranohet në shitje të lirë, organizon shitjen me ankand të sendit, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 552 të këtij Kodi.”.

Neni 33

Në fillim të nenit 555 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80 për qind e çmimit të caktuar sipas nenit 552 të këtij ligji.”.

Neni 34

Neni 557 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 557
Ankandi i dytë

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi heq sekuestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë debitorit dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të tij.”.

Neni 35

Në nenin 560 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Akti i përmbaruesit gjyqësor regjistrohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.”.

2. Në fjalinë e fundit fjala “detyrimisht” hiqet.

Neni 36

Neni 564 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 564

Nëse kreditori dhe debitori, brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të.

Përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar. Kundër vendimit të përmbaruesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë.”.

Neni 37

Në nenin 568 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “sendi i paluajtshëm” shtohen fjalët “gjykatë,

komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike, që ai i çmon të përshtatshme".

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas nenit 564 të këtij ligji.".

Neni 38

Në nenin 569, pas fjalëve "në zyrën e përmbarimit" shtohen fjalët "ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit".

Neni 39

Në nenin 573, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Rregullat e hollësishme për zhvillimin e ankandit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 40

Në nenin 574 paragrafi i parë, fjalët "5 ditë" zëvendësohen me fjalët "15 ditë".

Neni 41

Në nenin 575 fjalia e parë, pas fjalëve "përmbaruesi gjyqësor" shtohen fjalët "brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit.".

Neni 42

Në nenin 577, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të çmimit të ri.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të debitorit.".

Neni 43

Neni 581 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 581

Deklarimi i pasurive të debitorit

Përpara se të vihet sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve, që personat e tretë i detyrohen atij.

Për këtë përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin. Me marrjen e lajmërimit, pala debitore duhet të deklarojë pranë përmbaruesit gjyqësor se informacioni i paraqitur, për pasuritë e tij/saj apo të lëna në posedim personave të tretë, është i

saktë e i plotë. Me marrjen e lajmërimit të sekuestrimit, personi i tretë ndalohet t'ia dorëzojë debitorit kredinë dhe sendet e tij.

Kur debitori është person juridik, deklarimi i pasurisë mund të bëhet nga një anëtar i organit drejtues, që, sipas ligjit ose statutit, ka të drejtën e përfaqësimit kundrejt të tretëve ose, në rastin e procedurave të shpërndarjes apo të falimentimit të personit juridik, mund të bëhet nga likuidatori apo administratori i falimentimit.

Ndaj debitorit, i cili jep deklarim të rremë, zbatohet neni 320 i Kodit Penal.".

Neni 44

Në nenin 589, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.".

Neni 45

Në nenin 593 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë shfuqizohet.

2. Në paragrafin e dytë fjalët "Kur ky nuk gjendet ose kur banka nuk ka gjendje për debitorin" hiqen.

Neni 46

Neni 596 shfuqizohet.

Neni 47

Pas nenit 601 shtohet neni 601/a me këtë përmbajtje:

"Neni 601/a

Sendet e luajtshme, që ndodhen brenda sendit të paluajtshëm, të vënë në posedim, sipas nenit 602 të këtij Kodi, duhet të zhvendosen në përgjegjësinë e përmbaruesit dhe t'i dorëzohen debitorit ose familjarëve të tij menjëherë. Në rast se debitori ose familjarët e tij nuk janë të pranishëm gjatë lirimit, përmbaruesi mund t'i magazinojë pasuritë e luajtshme në:

a) mjedisin e liruar, në marrëveshje me kreditorin, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;

b) në mjediset, që disponon shërbimi përmbarimor, për ruajtjen e sendeve, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;

c) në një vend neutral, ku sendet e luajtshme mund të ruhen në mënyrë të sigurt, për një periudhe kohe prej 2 muajsh;

ç) në rezervat e shtetit, sipas rregullave në fuqi për ruajtjen e sendeve.

Për magazinimin e sendeve, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, shpenzimet paguhen nga debitori në çastin e marrjes në dorëzim të sendeve.

Nëse brenda 2 muajve nga lirimi, debitori nuk i kërkon sendet e tij të luajtshme, sipas shkronjave të mësipërme, apo nuk paguan të gjitha shpenzimet e lirimit dhe të magazinimit, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, sendet e luajtshme, të sekuestrueshme, do të shiten nga përmbaruesi gjyqësor, sipas dispozitave të pjesës IV të kreut II të këtij Kodi. Përmbaruesi, pasi zbret nga shuma e përfituar nga shitja me ankand të gjitha shpenzimet për lirimin dhe magazinimin e sendeve të debitorit, derdh pjesën që mbetet në një llogari bankare, në emër të

debitorit. Sendet e pasekuestrueshme i kthehen debitorit, pavarësisht vendit se ku ruhen, pa i kërkuar atij që të paguajë shpenzimet.

Sendet e luajtshme, të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm, që nuk mund të shiten dhe nuk kërkohen nga debitori, asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike shtetërore kalim kapital.".

Neni 48

Në nenin 609, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Në këto raste, gjykata shqyrton çështjen brenda 5 ditëve dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.".

Neni 49

Në nenin 610 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e dytë, pas fjalës "shqyrtohet" shtohen fjalët "brenda 20 ditëve".

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kundër veprimeve të personave, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitore mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit.".

3. Në paragrafin e fundit, fjalët "me cilësinë e personit të tretë" zëvendësohen me fjalët "me cilësinë e palës së paditur".

Neni 50

Në nenin 615 bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës "ç" shtohen shkronjat "d" e "dh" me këtë përmbajtje:

"d) kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;

dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor.".

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Pas rënies së masës së pezullimit, ekzekutimi vazhdon nga veprimi procedural i mbetur në çastin e pezullimit.".

Neni 51

Në nenin 616, shkronja "d" shfuqizohet.

Neni 52

Në nenin 617, fjalia e parë e paragrafit të tretë ndryshohet si më poshtë:

"Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formën e prerë, përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastin e parashikuar nga shkronja "b" e nenit 616 të këtij Kodi, i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit.".

Neni 53
Dispozitë kalimtare

Çështjet që janë në procedurë ekzekutimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas procedurave ligjore të mëparshme, derisa ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të jetë pezulluar, pushuar ose të ketë përfunduar.

Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6010, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi